

V E N D I M
PËR REGJISTRIMIN E PERSONIT JURIDIK

Në Tiranë, sot, më datë 30.10, 2001 (dymijë e nje), unë gjyqtar F. Sullaku pranë Gjykatës së rrethit Tiranë, shqyrtova kërkesën e paraqitur nga kërkuesi Tomorr Muçollari, për regjistrimin pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë, në regjistrin tregtar, të Shoqërisë "FLU-TO-NE" Sh.p.k. person juridik.

KONSTATOVA:

Se, kërkuesi Tomorr Muçollari, në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "FLU-TO-NE" Sh.p.k. kërkon regjistrimin si person juridik pranë Gjykatës së Rrethit Tirane si me poshtë :

- Emërtimi i shoqërisë është "FLU-TO-NE" Sh.p.k.
- Ortakë themelues të shoqërisë janë Zotërinjtë Tomorr MUÇOLLARI dhe Fluturim MUÇOLLARI.
- Administrator i shoqërisë do të jetë Zoti Tomorr Muçollari.
- Selia e Shoqërisë do të jetë në Këlcyrë, Përmet, pranë Fabrikës së Rrushit.
- Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është:
 - a) **Tregti materiale ndërtimi, bimë medicinale, mallra të ndryshme ushqimore e industriale, materiale ndërtimi (drasa guri, çimento, gëlqere etj), qymyr, pajisje hidrosanitare si dhe import eksporti i tyre.**
- Kapitali fillestar do të jetë 100.000 lekë dhe do të depozitohet nga ortakët themelues si më poshtë:
 - Ortaku Tomorr Muçollari 71.000 lekë = 71%.
 - Ortaku Fluturim Muçollari 29.000 lekë = 29%.
- Shoqëria do ta zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë prej 10 vjet. Veprimtaria e saj do të zhvillohet në Këlcyrë, Përmet dhe do të shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

Kërkesa është e drejtë dhe e bazuar në ligj.

PËR KËTO ARSYE

Në bazë të ligjit Nr. 7638, datë 19. 11. 1992

V E N D O S A

Pranimin e kërkesës.

Regjistrimin person juridik të Shoqërisë "FLU-TO-NE" Sh.p.k., me kushtet e mëposhtme:

- Emërtimi i shoqërisë është "FLU-TO-NE" Sh.p.k.
- Ortakë themelues të shoqërisë janë Zotërinjtë Tomorr MUÇOLLARI dhe Fluturim MUÇOLLARI.
- Administrator i shoqërisë do të jetë Zoti Tomorr MUÇOLLARI.
- Selia e Shoqërisë do të jetë në Këlcyrë, Përmet, pranë Fabrikës së Rrushit.
- Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është:

a) Tregti materiale ndërtimi, bimë medicinale, mallra të ndryshme ushqimore e industriale, materiale ndërtimi (drasa guri, çimento, gëlqere etj), qymyr, pajisje hidrosanitare si dhe import eksporti i tyre.

- Kapitali fillestar do të jetë 100.000 lekë dhe do të depozitohet nga ortakët themelues si më poshtë:

Ortaku Tomor Muçollari 71.000 lekë = 71%.

Ortaku luturim Muçollari 29.000 lekë = 29%.

Shoqëria do ta zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë prej 10 vjet. Veprimtaria e saj do të zhvillohet në Këlcyrë, Përmet dhe do të shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën e Shkallës së Apelit Tiranë.

GJYQTARE

Agjine Solaku
H. H. Solaku

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE

NR. 26586 / 1 VENDIMIT

V E N D I M
I G J Y Q T A R I T T E V E T E M

Ne Tirane , sot me date/06/ 2004 , une gjyqtare e Gjykate se Shkalles se Pare Tirane *Enkela Bajo* , mora ne shqyrtim kerkesen e paraqitur nga kerkuesi Tomorr Muçollari , administrator i shoqerise “ **FLU-TO-NE** ” SH.P.K. per depozitim ne regjistrin tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane , te vendimit nr. 1 date 02/06/2004 te asamblese se ortakeve te kesaj shoqerie :

K O N S T A T O V A S E

Shoqeria tregtare “FLU-TO-NE “ SH.P.K.. eshte regjistruar ne regjistrin tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane me vendimin nr. **26586 date 30/10/2001** me ortaket Tomorr Muçollari dhe Fluturim Muçollari dhe administrator ortak z. Tomorr Muçollari.

Me vendimin nr. 1 date 02/06/2004, asambleja e ortakeve te kesaj shoqerie ka vendosur:

- **Te shtohet objekti i veprimtarise se shoqerise “ FLU-TO-NE ” SH.P.K. ne :**
- Prodhimi, perpunimi, import- eksport, tregeti me shumice dhe pakice i materialeve te ndertimit, materialeve inerte(si gure gelqerore pllakore, gure pllakore ranorike, mermere, granite, interte te cfaredo lloji) .
- Prodhimi, nxjerrja dhe perpunimi, import- eksport, tregeti me shumice dhe pakice i lendeve minerare te cdo lloji sic jane percaktuar ne ligjin minerar te Shqiperise .
- Perdorimi dhe transporti i lendeve plasese ne shfrytezimin e minierave, import- eksporti dhe tregetimi i tyre me shumice dhe pakice.
- Depozitimi i ketij vendimi ne regjistrin tregetar te gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Kjo kerkese eshte e bazuar ne ligj dhe duhet pranuar.

P E R K E T O A R S Y E

Bazuar ne ligjin nr. 7667 date 28.1.1993 dhe ne ligjin nr.7638 date 19.11. 1992, si dhe ligjit nr.8770 dt.19.04.2001.

V E N D O S A

Pranimin e kerkeses.

Depozitim ne regjistrin tregetar te Gjykates se Shkalles se Pare Tirane te vendimit Nr.1 dt. 02/06/2004 te asamblese se ortakeve te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar “ FLU-TO-NE ” SH.P.K. dhe aktet qe bejne fjale per :

Shtimin e objektit te veprimtarise te shoqerise “ FLU-TO-NE ” SH.P.K. ne :

- Prodhimi, perpunimi, import- eksport, tregeti me shumice dhe pakice i materialeve te ndertimit, materialeve inerte(si gure gelqerore pllakore, gure pllakore ranorike, mermere, granite, interte te cfaredo lloji) .

- Prodhimi, nxjerrja dhe perpunimi, import-eksport, tregeti me shumice dhe pakice i lendeve minerare te cdo lloji sic jane percaktuar ne ligjin minerar te Shqiperise .
- Perdorimi dhe transporti i lendeve plasese ne shfrytezimin e minierave, import-eksporti dhe tregetimi i tyre me shumice dhe pakice.

Urdherohet zyra e regjistrimit tregetar te beje ndryshimet perkatese ne kolonen perkatese, nr _____

Kunder vendimit lejohet ankimi.

GJYQTARE

Enkela Bajo



URDHËR REGJISTRIMI
GJYKATA E RRETHIT TIRANË
REGJISTRI I SHOQËRIVE TREGTARE

URDHËR REGJISTRIMI

Kolona I	Numri i Regjistrimit Tregtar: <u>26586</u>
Kolona II	A. Emri i Shoqërisë: <u>"Flu-TO-Me" sh.p.k</u> B. Selia: _____ C. Objekti: <u>Trepëhim me shumicë e politikë</u> <u>te mallrave të + industrisë,</u> <u>ushqimorë etj.</u> D. Kapitali: <u>100.000 Lekë</u>
Kolona III	A. Ortakët: <u>Tomox Muscolloz 71%</u> <u>Fluturim Muscolloz 29%</u> B. Administratorët: <u>Tomox Muscolloz,</u> <u>i bix. ; Qamodama, ditë 1965,</u> <u>lindur në këllaxë - Tërmet,</u> <u>banues në Tërmet.</u>
Kolona IV	Kohëzgjatja: _____
Kolona V	Shënime mbi aktet e shoqërisë: A. Data e nënshkrimit: <u>29.10.2001.</u> B. Data e regjistrimit: <u>30.10.2001.</u> C. Statuti fletë: <u>6 fletë</u> D. Akti i themelimit fletë: <u>2 fletë</u>

Shënime: Shuma prej 100.000 Lekë rezultoi
e depozituar pranë bankës S. Rexho kjo
me certifikatim e ditë 20.10.2001.

GJYOTARE
Fajzi me Sollaku.
Hollaku



AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË "FLU-TO-NE" SH.P.K

Në Këlcyrë, Përmet, sot, më 29.10. 2001,

1. Fluturim MUÇOLLARI, i biri i Ramadanit, lindur në Këlcyrë, Përmet më 1969, banues në Kuqar, Përmet, dhe

2. Tomorr MUÇOLLARI, i biri i Ramadanit, lindur në Këlcyrë Përmet më 1965, banues në Këlcyrë, Përmet.

Madhorë, me zotësi të plotë për të vepruar, të cilët kanë vendosur të nënshkruajnë Aktin e Themelimit si më poshtë për një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i të cilit rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i tij, i cili është pjesë përbërëse e kësaj kontrate.

NENI 1

Emërtimi i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar është "FLU-TO-NE" SH.P.K.

NENI 2

Selia e Shoqërisë është në Këlcyrë, Përmet, pranë Fabrikës së Rrushit.

NENI 3

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë është 10 (dhjetë) vjet duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Shoqërive në Gjykatën e Rrethit Tiranë.

NENI 4

4.1. Shoqëria do të kryejë këtë aktivitet:

Tregti materiale ndërtimi, bimë medicinale, mallra të ndryshme ushqimore e industriale, materiale ndërtimi (drasa guri, çimento, gëlqere etj), qymyr, pajisje hidrosanitare si dhe import eksporti i tyre.

Përveç veprimeve të parashikuara më lart, në veprimtarinë e sipërmarrjeve të shoqërisë do të hyjë në çdo veprimtari tjetër industriale, tregtare, financiare dhe ndërtimi që do të konsiderohet nga Asambleja e Ortakëve e nevojshme dhe e përshtatshme për arritjen e objektit të veprimtarisë së shoqërisë.

4.2. Për realizimin e objektit të saj Shoqëria mund të bashkëpunojë me shoqëri të tjera me objekt të njëjtë brenda dhe jashtë vendit.

NENI 5

Kapitali themeltar i Shoqërisë është fiksuar në vlerën 100.000 Lekë dhe përbëhet nga kontributet e ortakëve themelues në masën si vijon:


1. TOMORR MUÇOLLARI, zotëron 71% të kapitalit themeltar të barabartë me 71000 lekë,

2. FLUTURIM MUÇOLLARI, zotëron 29% të kapitalit themeltar të barabartë me 29000 lekë,

NENI 6

Kapitali themeltar është i ndarë në 100 (njëqind) pjesë kapitali, të gjitha të nënshkruara e të paguara, secila prej tyre me një vlerë minimale prej 100 (njëqind) Lekë.

Sipas kontributeve të mësipërme kuotat zotërohen si më poshtë:
1. TOMORR MUÇOLLARI, zotëron 71% të kuotave të kapitalit themeltar nga numri 01 deri në 71.
2. FLUTURIM MUÇOLLARI, zotëron 29 % të kuotave të kapitalit themeltar nga numri 72 deri në 100.



NENI 7

Pjesët e kapitalit janë të transferueshme ndaj të tretëve sipas procedurave të parashikuara nga Statuti.

NENI 8

Administrator i shoqërisë do të jetë Zoti Tomorr Muçollari.

Administratorit të emëruar në këtë akt themelimi i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të zbatuar të gjitha formalitetet e parashikuara dhe përmbushjen e të gjitha detyrimeve për themelimin e shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi.

Ortakët hartojnë Statutin e Shoqërisë dhe e nënshkruajnë atë. Kërkesa për regjistrimin e shoqërisë paraqitet nga administratori i Shoqërisë.

NENI 9

Ortakëve të rinj që mund të hyjnë në shoqëri u kërkohet detyrimi për ruajtjen e sekretit përsa i takon dokumentacionit teknik, informacionit dhe eksperiencave të shkëmbyera reciprokisht dhe për ato me të cilat ata njihen gjatë zhvillimit të aktivitetit të Shoqërisë.

NENI 10

Kushtet e punës, si përfshihen, oraret e punës, pushimet dhe sigurimet shoqërore të personelit do të rregullohen nga kontrata kolektive ose individuale e punës, si edhe nga legjislacioni shqiptar në fuqi.

NENI 11

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga interpretimi, zbatimi dhe zgjidhja e këtij Akti Themelimi, si edhe mosmarrëveshjet që mund të lindin midis ortakëve të ardhshëm të mundshëm (përveç atyre që lindin nga raporte personale apo jashtë Shoqërisë) ose mosmarrëveshjet midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të shtrohen për zgjidhje miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë midis të interesuarve.

Në rast se mosmarrëveshja nuk arrihet të zgjidhet me mirëkuptim, zgjidhja e saj do t'i besohet gjykatës së Rrethit Tiranë.

Lexuar, nënshkruar nga

ORTAKËT THEMELUES

TOMORR MUÇOLLARI

Tomorr Muçollari
[Signature]

FLUTURIM MUÇOLLARI

Fluturim Muçollari
[Signature]

STATUTI SHOQËRISË

"FLU-TO-NE" SH.P.K.



KAPITULLI I EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA

Neni 1 - Forma

1.1. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "FLU-TO-NE" Sh.p.k. (këtu e më poshtë "SHOQËRIA") krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe rregullohet nga ky statut dhe nga akti i saj i themelimit. Statuti është pjesë integrale e Aktit të Themelimit.

1.2. Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

1.3. Akti i Themelimit dhe Statuti janë në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe çdo çështje e paparashikuar shprehimisht në to, rregullohet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Neni 2 - Emërtimi

Emërtimi i SHOQËRISË është "FLU-TO-NE" Sh.p.k.

Neni 3 - Objekti

3.1. SHOQËRIA do të kryejë këtë aktivitet:

a) **Tregti materiale ndërtimi, bimë medicinale, mallra të ndryshme ushqimore e industriale, materiale ndërtimi (drasa guri, çimento, gëlqere etj), qymyr, pajisje hidrosanitare si dhe import eksporti i tyre.**

Përveç veprimeve të parashikuara më lart, në veprimtarinë e sipërmarrjeve të shoqërisë do të hyjë në çdo veprimtari tjetër industriale, tregtare, financiare dhe ndërtimi që do të konsiderohet nga Asambleja e Ortakëve e nevojshme dhe e përshtatshme për arritjen e objektit të veprimtarisë së shoqërisë.

3.2. Për realizimin e objektit të saj SHOQËRIA mund të bashkëpunojë me shoqëri të tjera me objekt të njëjtë brenda dhe jashtë vendit.

Neni 4 - Selia

4.1. Selia zyrtare e SHOQËRISË ndodhet në Këlcyrë, Përmet, pranë Fabrikës së Rrushit.

4.2. Transferimi i selisë së SHOQËRISË në një vend tjetër mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së jashtëzakonshme të ortakëve të marrë me miratimin e të dy ortakëve.

Neni 5 - Kohëzgjatja

5.1. Kohëzgjatja e aktivitetit të SHOQËRISË do të jetë për një periudhë prej 10 (dhjetë) vjet, duke filluar që prej datës së regjistrimit të saj në Regjistrin e Shoqërive Tregtare të Gjykatës së Rrethit Tiranë.

5.2. SHOQËRIA mund të shpërndahet edhe përpara këtij afati ose ky afat mund të zgjatet me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme të ortakëve.

Neni 6 - Përgjegjësia

6.1. SHOQËRIA nuk përgjigjet për detyrimet e marra për qëllime që nuk përputhen me ato të përcaktuara nga Statuti dhe Akti i Themelimit.

6.2. SHOQËRIA nuk përgjigjet për detyrimet e marra nga ortakët në emër të tyre personal ndaj personave fizikë ose juridikë, enteve apo Shtetit.

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA E PJESËVE TË KAPITALIT

Neni 7 - Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i SHOQËRISË është fiksuar në vlerën 100.000 Lekë dhe përbëhet nga kontributet e ortakëve themelues në masën si vijon:

1. TOMORR MUÇOLLARI, zotëron 71% të kapitalit themeltar të barabartë me 71000 lekë,
2. FLUTURIM MUÇOLLARI, zotëron 29% të kapitalit themeltar të barabartë me 29000 lekë,

Neni 8 - Kontributet dhe pjesët e kapitalit

Kapitali themeltar është i ndarë në 100 (njëqind) pjesë kapitali, të gjitha të nënshkuara e të paguara, secila prej tyre me një vlerë minimale prej 1.000 (njëmijë) Lekë.

Sipas kontributeve të mësipërme kuotat zotërohen si më poshtë:

1. TOMORR MUÇOLLARI, zotëron 71% të kuotave të kapitalit themeltar nga numri 01 deri në 71.
2. FLUTURIM MUÇOLLARI, zotëron 29 % të kuotave të kapitalit themeltar nga numri 72 deri në 100.

Neni 9 - Rritja e kapitalit themeltar

9.1. Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në çdo moment një ose më shumë herë, me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme të marrë me miratimin e të dy ortakëve.

9.2. Në rast rritje të kapitalit, të gjithë ortakët kanë të drejtën të nënshkruajnë rritjen në raport me pjesët e kapitalit të zotëruara, me pjesëmarrjen e 100% të pjesëve të kapitalit.

Neni 10 - Zvogëlimi i kapitalit themeltar

10.1. SHOQËRIA mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendim të Asamblesë së Jashtëzakonshme të marrë me 100% të pjesëve të kapitalit. Në asnjë rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuara nga ligji.

10.2. Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në mënyrë propocionale me pjesët e kapitalit të zotëruara.

Neni 11 - Transferimi i pjesëve të kapitalit

11.1. Pjesët e kapitalit mund t'u transferohen të tretëve tërësisht ose pjesërisht vetëm me vendimin e Asamblesë së Jashtëzakonshme të marrë me 100% të pjesëve të kapitalit.

11.2. Në rast transferimi të çdo lloj titulli të pjesëve të kapitalit tek të tretët, ortakët e tjerë të SHOQËRISË rezervojnë të drejtën e parablerjes së pjesëve të kapitalit, në raport me pjesët e tyre të kapitalit me të njëjtat kushte e me të njëjtin çmim që i janë ofruar palës së tretë.

11.3. Në këtë rast ortaku që do të shesë u njofton ortakëve të tjerë çmimin e ofruar prej të tretit, duke u paraqitur edhe provën me shkrim të ofertës së shitjes, dhe ortakët e tjerë kanë 30 (tridhjetë) ditë nga momenti i marrjes së letrës për t'i komunikuar

ortakut që do të shesë dëshirën e tyre për të ushtruar ose jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ortakët e tjerë nuk përgjigjen brenda afatit të parashikuar, konsiderohet se ata kanë hequr dorë prej të drejtës së tyre të parablerjes.

11.4. Në rast se njeri prej ortakëve, të cilit i bëhet oferta për të blerë sipas të drejtës së parablerjes nuk dëshiron ta ushtrojë këtë të drejtë, ortaku tjetër i cili ka përfituar e ushtruar tashmë të drejtën e tij të parablerjes për pjesën e tij, mund ta ripërdorë këtë të drejtë mbi të gjitha ose pjesë të kapitalit të cilat i ishin ofruar sipas të drejtës së parablerjes ortakur që nuk dëshironte ta ushtronte atë.

11.5. Në rast se vetëm njeri prej ortakëve dëshiron ta ushtrojë të drejtën e parablerjes, pjesët e kapitalit të ofruara mbi bazën e së drejtës së parablerjes do t'i transferohen atij tërësisht.

11.6. Për këtë qëllim, ortaku i interesuar që do të ripërdorë të drejtën e tij të parablerjes duhet t'i njoftojë vendimin e tij ortakut që dëshiron të shesë, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh që prej marrjes së lajmit për mosushtrim të së drejtës së parablerjes nga njëri prej ortakëve.

11.7. Të gjitha njoftimet e mësipërme bëhen me shkrim.

KAPITULLI III ASAMBLEJA, ADMINISTRATORËT, KONTROLLI

Neni 12 - Asambleja e ortakëve dhe kompetencat përkatëse.

12.1. Organi vendim-marrës i SHOQËRISË është Asambleja e Ortakëve.

12.2. Vendimet që merr ky organ me shumicë votash janë të detyrueshme për ortakët që mungojnë ose kanë mendim të ndryshëm, me përjashtim të rastit kur kanë të drejtën e ankimit, e drejtë kjo e cila ushtrohet në rastet, kohën dhe format që parashikohen nga ligji.

Neni 13 - Të drejtat e pjesëmarrjes dhe votimit.

13.1. Çdo ortak ka të drejtë të marrë pjesë në çdo mbledhje të Asamblesë, të paraqesë mendimin e vet dhe të japë aq vota sa pjesë të kapitalit themeltar ka derdhur.

13.2. Çdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një delegat i pajisur me një prokurë të shkruar, me anë të të cilit mund të japë votën e tij.

13.3. Ortaku nuk mund të delegojë të drejtën për të votuar për një pjesë të kapitalit, nëse voton personalisht për tjetrën.


Neni 14 - Thirrja e Asamblesë

14.1. Asambleja e Zakonshme thirret të paktën 4 (katër) herë në vit, një prej të cilave brenda 6 muajve nga mbyllja e vitit për miratimin e bilancit, të raporteve të administratorëve dhe të ekspertit kontabël, në se ka, veç inventarit.

14.2. Asambleja mund të thirret në çfardollosj momentit nga administratorët, si dhe nga një ose më shumë ortakë që përfaqësojnë 1/4 e kapitalit themeltar.

14.3. Asambleja duhet të thirret nëpërmjet një letre rekomande që duhet t'u dërgohet ortakëve - në adresat që janë shkruar në Librin e Ortakëve, të paktën 10 (dhjetë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat do të vendoset, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.

14.4. Asambleja do të mbahet rregullisht edhe pa respektuar këto formalitete, nëse marrin pjesë apo janë të përfaqësuar të gjithë ortakët. Asambleja e Zakonshme vendos mbi të gjitha çështjet që nuk janë në kompetencë të Asamblesë së Jashtëzakonshme dhe specifikisht vendos mbi:



- a. Emërimin apo zëvendësimin e Administratorit;
- b. Organizimin e zhvillimin e aktivitetit;
- c. Organizimin dhe zhvillimin e bilancit preventiv;
- *d. Llogaritë vjetore;

e. Raportet e administratorëve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar, inventarin; f. Vendimin për shpërndarjen e fitimeve.

14.5. Asambleja e Zakonshme quhet e mbledhur rregullisht dhe mund të marrë vendime vetëm nëse janë të pranishëm 3/4 (tre të katërtat) e ortakëve të shoqërisë.

14.6. Asambleja e jashtëzakonshme është e mbledhur në mënyrën e duhur dhe merr vendime në thirrjen e parë me pjesëmarrjen dhe me votën pro të 3/4 të ortakëve të shoqërisë.

14.7. Asambleja e Jashëzakonshme me votën e 3/4 të anëtarëve vendos:

- a. Mbi ndryshimet e Aktit të Themelimit dhe të Statutit;
- b. Mbi formimin e filialeve, degëve dhe përfaqësive jashtë shtetit;
- c. Mbi rritjen apo reduktimin e kapitalit themeltar;
- d. Mbi ndryshimet në objekt dhe mbi blerjen e pjesëve të kapitalit në shoqëri të tjera;

e. Mbi transferimin e pjesëve të kapitalit themeltar;

f. Pranimin e ortakëve të rinj në shoqëri.

14.8. Çdo mbledhje drejtohet nga të dy administratorët ose në mungesë të të dyve edhe nga njeri prej tyre. Për mbajtjen e procesverbalit Asambleja cakton një Sekretar, i cili mund të mos jetë ortak.

14.9. Vendimet e Asamblesë duhet të shkruhen në procesverbal, i cili nënshkruhet nga të gjithë ortakët, administratori që nuk është ortak dhe nga Sekretari.

14.10. Për emërtimin apo zëvendësimin e administratorit votohet me 3/4 të votave të ortakëve. Administratori jo ortak mund të largohet nga administrimi i shoqërisë duke njoftuar me shkrim asamblenë e ortakëve 1 (një) muaj përpara largimit. Asambleja në këtë rast voton vetëm administratorin e ri, ndërsa largimi është fakt. Administratori ortak mund të japë dorëheqjen si administrator në mënyrë të përvokueshme. Shoqëria për ecurrinë e saj harton rregullore të brendshme të miratuar me 3/4 e kuotave të kapitalit themeltar.

Neni 15 - Administrimi

16.1. SHOQËRIA do të administrohet nga administratorët e saj.

16.2. Administratorët qëndrojnë në postin e tyre për sa kohë vendos Asambleja e Ortakëve.

16.3. Administratorët kanë të gjitha kompetencat administrative të zakonshme dhe të jashtëzakonshme që bëjnë pjesë në objektin e Shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji apo Statuti i jep Asamblesë.

16.4. Administrator i SHOQËRISË është emëruar Zoti Tomorr MUÇOLLARI

Neni 16 - Eksperti kontabël i autorizuar

17.1. Nëse është e nevojshme ose kërkohet nga ligji, kontrolli i bilancit financiar dhe librave të kontabilitetit të SHOQËRISË do t'i besohet një eksperti kontabël të autorizuar, të emëruar për një periudhë 5 (pesë) vjeçare (dhe i rizgjedhshëm) me miratimin e të dy ortakëve.

17.2. Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet me të njëjtën procedurë si ajo e emërimit.

KAPITULLI IV VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE

Neni 17 - Viti financiar dhe bilanci vjetor

18.1. Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të çdo viti.

18.2. Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregatë të Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe përfundon në 31 dhjetor të të njëjtit vit.

18.3. Bilancet vjetore, inventari, raportet e administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar, në se ka, miratohen nga Asambleja e Zakonshme me 100% të kuotave të kapitalit.

18.4. Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhen brenda 6 muajsh (6) muajve që nga fundi i vitit financiar.

Neni 18 - Fitimet

19.1. Fitimet neto që rezultojnë nga bilanci tremujor, duke zbritur 5% (pesë përqind) që caktohen për rezervën ligjore deri sa të arrihet 10% (dhjetë përqind) e kapitalit themeltar, u shpërndahen ortakëve në propocion me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruar respektivisht.

19.2. Ortakët detyrohen të shlyejnë detyrimet ndaj shoqërisë sipas rregullave të përcaktuara nga ajo.

KAPITULLI V MBARIMI DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË

Neni 19 - Shkrija

20.1. SHOQËRIA mbaron me të përfunduar afati i parashikuar nga Statuti, ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji ose me anë të një vendimi të Asamblesë së Jashtëzakonshme të Ortakëve.

20.2. SHOQËRIA nuk mbaron në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, vdekjes, ose falimentimit të ortakëve.

Neni 20 - Likuidimi

21.1. Në rast mbarimi, SHOQËRIA duhet të likujdohet, duke iu nënshtruar procedurave të likuidimit.


21.2. Për të administruar këtë procedurë, Asambleja emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të SHOQËRISË, mbi operacionet e likujdimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likujdimin.

21.3. Me përfundimin e procedurës së likujdimit të SHOQËRISË, Asambleja do të vendosë, me 100% të kuotave të kapitalit, mbi bilancin vjetor përfundimtar, mbi vlefshmërinë e punës së kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likujdimit.

21.4. Pas pagesës së kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'u shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likujdimit ortakëve në propocion me pjesët e zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.

Neni 21 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

22.1. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin, zbatimin apo zgjidhjen e këtij Statuti dhe të Aktit të Themelimit të SHOQËRISË, si edhe ato që mund të lindin midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose



midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë nëpërmjet të interesuarve.
22.2. Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ajo mund t'yrbesohet një gjykatë shqiptare.

Lexuar, nënshkruar nga

ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË "FLU-TO-NE" SH.P.K.

TOMORR MUÇOLLARI

Tomor Muçollari
[Signature]

FLUTURIM MUÇOLLARI

Fluturim Muçollari
[Signature]


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA E NOTERËVE TIRANË
Nr. 1368 Rep.
Nr. 276 Kol.

VËRTETIM

Në Tiranë, sot, më datë 28.10. 2008, në Zyrën e Noterisë Tiranë, para meje Noteres, u paraqitën personalisht:

1. Fluturim Muçollari, i biri i Ramadanit, lindur në Këlcyrë, Përmet më 1969, banues në Kuqar, Përmet, dhe
2. Tomorr Muçollari, i biri i Ramadanit, lindur në Këlcyrë Përmet më 1965, banues në Këlcyrë, Përmet

në cilësinë e Ortakëve Themelues të Shoqërisë "FLU-TO-NE" sh.p.k. në formim e sipër, të cilët më deklaruan se e kanë hartuar Statutin e mësipërm jashtë zyrës së noterit dhe me vullnetin e tyre të plotë e të lirë e nënshkruajnë atë para meje. Unë noteri pasi bindem e legalizoj atë.




REPUBLIKA E SHQIPËRISE
DHOMA E NOTEREVE TIRANE
NOTERE SILVANA MERKO
NR. 3 Regjistrit

VERTETIM

Vertetoj se sot më date 20. 10. 2001 (njezete tetor dymije e nje) para meje noteres Silvana Merko, e dhomës se noterise Tirane , m'u paraqiten personalisht ortaket Tomorr Mucollari dhe Fluturim Mucollari, te cilët depozituan shumën prej 100 000 (njeqind mije) leke , si kapital fillestar për shoqerine ne krijim e sipër "FLU-TOGNE" shpk.

NOTERE
/ SILVANA MERKO /



20506/14
KERKESE

3 E Bayo 06 04
NEPERSHOR 2004

KERKUESI: Tomorr Muçollari, banues ne Permet, madhor, me zotesi te plate juridike dhe per te vepruar, administrator i shoqerise "FLU-TO-NE" sh.p.k.

OBJEKTI: Depozitimi ne regjistrin tregetar te Gjykates se rethit Tirane te vendimit nr. 1 date 02/06/2004 te ortakut te vetem te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar "FLU-TO-NE" SH.P.K. ne baze te n. 243 te ligjit "Per shoqerite tregetare"

PERPARA GJYKATES SE SHKALLES SE PARE
TIRANE

Shoqeria tregetare "FLU-TO-NE" SH.P.K. eshte regjistruar ne regjistrin tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane me vendim nr. 15586 date 30.10.2001 me ortakut Tomorr Muçollari dhe Futurim Muçollari. Me vendimin nr 1 date 02/06/2004 asambleja e ortakëve te kesaj shoqerie ka vendosur:


- Te shpohet objekti i veprimtarise se shoqerise "FLU-TO-NE" SH.P.K. ne:
- Prodhimi, perpunimi, import-eksport, tregeti me shumice dhe pakice i materialeve te ndertimit, materialeve inerte (si gure gelqerore pllakore, gure pllakore ramorike, mermere, granite, interte te cfaredo lloji).
- Prodhimi, njerzia dhe perpunimi, import-eksport, tregeti me shumice dhe pakice i lendeve minerare te cdo lloji sic jane percaktuar ne ligjin minerar te Shqiperise.
- Perdorimi dhe transporti i lendeve plasese ne shfrytezimin e minierave, import-eksporti dhe tregetimi i tyre me shumice dhe pakice.
- Depozitimi i ketij vendimi ne regjistrin tregetar te gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

Per sa me lart kerkoi qe kjo kerkese te pranohet.

KERKUESI
Tomorr Muçollari

Tomorr Muçollari

**SHOQERIA " FLU-TO-NE " SH.P.K.
TIRANE**



VENDIM NR.1

I asamblese se ortakeve te shoqerise "FLU-TO-NE " SH.P.K.

Sot me date 02.06.2004 , asambleja e ortakeve te shoqerise tregtare "FLU-TO-NE " SH.P.K. regjistruar ne Gjykaten e rrethit Tirane ,me vendimin nr. 6586 date 30/10/2001,me pjesemarrjen e te dy ortakeve te shoqerise qe perbejne 100% te kuotave te kapitalit themeltar te kesaj shoqerise ne mbledhjen e jashtezakoneshme te saj :

KONSTATON SE :

Shoqeria tregtare "FLU-TO-NE " SH.P.K.. eshte regjistruar ne regjistrin tregetar te Gjykates se Rrethit Tirane me vendimin nr. 26586 date 30/10/2001 me ortaket Tomorr Muçollari dhe Fluturim Muçollari dhe administrator ortak z. Tomorr Muçollari.

Per nevoja te shoqerise asambleja e ortakeve te kesaj shoqerise shoqerise :

VENDOSI

- Te shtohet objekti i veprimtarise se shoqerise " FLU-TO-NE " SH.P.K. ne :
- Prodhimi, perpunimi, import- eksport, tregeti me shumice dhe pakice i materialeve te ndertimit, materialeve inerte(si gure gelqerore pllakore, gure pllakore ranorike, mermere, granite, interte te cfaredo lloji) .
- Prodhimi, nxjerrja dhe perpunimi, import- eksport, tregeti me shumice dhe pakice i lendeve minerare te cdo lloji sic jane percaktuar ne ligjin minerar te Shqiperise .
- Perdorimi dhe transporti i lendeve plasese ne shfrytezimin e minierave, import- eksporti dhe tregetimi i tyre me shumice dhe pakice.
- Depozitimi i ketij vendimi ne regjistrin tregetar te gjykates se Shkalles se Pare Tirane.

PER SA ME SIPER ORTAKET RANE DAKORT DHE NENSHKRUAJNE

Tomorr Muçollari
[Signature]

Fluturim Muçollari
[Signature]

KËRKESË

29 OTT. 2001
28.10.2001
Z. Bellas
F. Haxhi

KËRKUESA: Tomor MUÇOLLARI, i biri i Ramadanit, datëlindja 1965, lindur në Këlcyrë-Përmet, banues në Këlcyrë-Përmet, në cilësinë e Administratorit të Shoqërisë.

26586

OBJEKTI : Regjistrimi si person juridik të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "FLU-TO-NE" sh.p.k.

Për kompetencë

GJYKATËS SË RETHIT
TIRANË

20 regjistrimet hërkues
Tiranë më 30.10.2001
Gjyqtare Regjistrimit Nollakaj
Nollakaj

Unë, kërkuesi Tomorr Muçollari, në cilësinë e administratorit të Shoqërisë "FLU-TO-NE" Sh.p.k. kërkojmë miratimin dhe regjistrimin si person juridik të "FLU-TO-NE" Sh.p.k. me kushtet e mëposhtme:

- Emërtimi i shoqërisë është "FLU-TO-NE" Sh.p.k.
- Ortakë themelues të shoqërisë janë Zotërinjtë Fluturim MUÇOLLARI dhe Tomorr MUÇOLLARI.

- Administratori i shoqërisë do të jetë Zoti Tomorr MUÇOLLARI.
- Selia e Shoqërisë do të jetë në Këlcyrë-Përmet, pranë Fabrikës së Rrushit.
- Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë:

Tregti materiale ndërtimi, bimë medicinale, mallra të ndryshme ushqimore e industriale, materiale ndërtimi (drasa guri, çimento, gëlqere etj), qymyr, pajisje hidro-sanitare si dhe import eksporti i tyre.

- Kapitali fillestar do të jetë 100.000 lekë dhe do të depozitohet nga ortakë themelues si më poshtë:

Ortaku Tomorr Muçollari 71.000 lekë = 71%.

Ortaku Fluturim Muçollari 29.000 lekë = 29%.

- Shoqëria do ta zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë mbi 10 vjet. Veprimtaria e saj do të zhvillohet në Këlcyrë, Përmet dhe do të shtrihet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë saj.

Bashkëngjitur me këtë kërkesë janë edhe dokumentat përkatës: Akti themelimit dhe Statuti i Shoqërisë "FLU-TO-NE" sh.p.k.

KËRKUESI

TOMORR MUÇOLLARI

[Signature]

